



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E  
KADASTRËS

DHOMA KOMBËTARE E  
NOTERËVE

Prot 5243  
Datë 15/04/2024

Kr. Prot. 4966  
Datë 15.04.2024

ANEKS 1/2

**“PËR DISA NDRYSHIME NË PROTOKOLLIN TEKNIK TË  
NDËRVEPRIMIT ASHK-NISA (ANEKSI 1) TË MARRËVESHJES SË  
BASHKËPUNIMIT NR.185 PROT ; NR.2729 PROT. DATË 08.01.2020, TË  
LIDHUR MIDIS AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS DHE  
DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERËVE”**

Ky Aneks nënshkruhet sot në datë 13 / 04 2024, bazuar në pikën 4, të nenit 10 “Dispozita të fundit”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve, me nr.185 Prot - ASHK; dhe nr. 2729 Prot - DHKN datë 08.01.2020.

Palët në Marrëveshje bien dakord që në Aneksin 1, “Protokolli teknik i ndërveprimit ASHK-NISA”, të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në gjermën “B”, Rregullat dhe Procedurat e Kërkesave Online, paragrafi i katërt të ndryshohet si vijon:

“Me administrimin nëpërmjet sistemit elektronik të kërkesës, dokumentin elektronik noterial<sup>1</sup> dhe cdo dokumentacion tjetër, të nënshkruar elektronikisht<sup>2</sup> nga noteri sipas kriterëve ligjore referuar akteve ligjore në fuqi, nëpërmjet sistemit “NISA”, ASHK kryen verifikimin e dokumentacionit sipas afateve të parashikuara në Vendimin e Këshillit Drejtues nr.15, datë 30.09.2022, “Për miratimin e listës së shërbimeve kadastrale që mund të ofrohen në mënyrë të përshpejtuar, tarifave të diferencuara

<sup>1</sup> Ligji nr.110/2018 “Për noterinë”

Neni 126 “Procedurat për kalimin e pasurisë së paluajtshme”-

1. Akti noterial për kalimin ose njohje në pronësi mbi sendet e paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to , kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e pales nëpërmjet sistemit elektronik mbi pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij verifikimi, pala i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të nevojshme, si dhe autorizimin e saj me shkrim.

2. Noteri shënon në aktin noterial për kalimin e pasurisë së paluajtshme, verifikimin e bërë dhe i bashkëlidh rezultatin e verifikimit.

<sup>2</sup> Ligji nr.10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”

Neni 5 “Vlefshmëria ligjore e dokumentit elektronik” - Dokumenti elektronik ka vlefshmëri ligjore vetëm në ato raste kur ai krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve të ngjashme dhe programeve elektronike, duke përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 6 “Kritere të dokumentit elektronik” – “Përgjatë ciklit të dokumentit, në veprimet e përfshira në të, dokumenti elektronik duhet të sigurojë:

a) nënshkrim elektronik dhe/ose vulë elektronike, sipas legjislationit në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;

dhe afateve të trajtimit”. Kur dokumentacioni është në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi dhe akti noterial i paraqitur parashikon pagesën e tatimit/taksës, ASHK përllëgarit detyrimet dhe dërgon nëpërmjet sistemit, formularin përkatës. Në rast pasaktësie në plotësimin e kërkesës, mungesë në dokumentacion e skanuar bashkëlidhur aplikimit, apo mungesë të nënshkrimit elektronik, ASHK nëpërmjet kërkesës për plotësim dokumentacion, (AV0), kërkon plotësimin e pasaktësisë dhe mungesave.

2. Në gjermën “B”, Rregullat dhe Procedurat e Kërkesave Online, paragrafi i shtatë të ndryshohet si vijon:

“Me dërgimin e kërkesës, dokumentit noterial dhe çdo dokumentacioni tjetër, secili i nënshkruar elektronikisht nga noteri, secili në format “PDF”, dhe me kryerjen e pagesës sipas afateve, noteri ka detyrimin të depozitojë në protokollin e ASHK-së jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës nëpërmjet sistemit, aktin noterial dhe dokumentacionin shoqërues në origjinal dhe në format hardcopy nëpërmjet shërbimit postar. Mospërmbushja e këtij detyrimi do të konsiderohet shkelje dhe do të përbëjë shkas për fillimin e procedurës për marrjen e masave disiplinore ndaj Noterit.

Dokumentimi i dorëzimit në format analog, nëpërmjet shërbimit postar të dokumentacionit nga noteri, kryhet nga ASHK në librin e protokollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

3. Në gjermën “B”, Rregullat dhe Procedurat e Kërkesave Online, paragrafi i nëntë të ndryshohet si vijon:

“Pas verifikimit të kryerjes së pagesës për shërbimin e kërkuar nga ana e noterit (qytetarit nëpërmjet noterit) me administrimin në rrugë digjitale të kërkesës, dokumentit noterial dhe çdo dokumentacioni tjetër, secili i nënshkruar elektronikisht nga noteri, në format “PDF”, edhe pse dokumentacioni në mënyrë fizike nuk është administruar, ASHK përfundon procesin e aplikimit duke kthyer përgjigjen përkatëse pranë noterit në mënyrë elektronike në llogarinë e vet në sistemin NISA”

Ky Aneks hyn në fuqi në datën 15 / 09 2024.

AGJENCIA  
SHTETËRORE E KADASTRËS

Drejtor i Përgjithshëm

Dallëndyshe BICI

DHOMA  
KOMBËTARE E NOTERËVE

Kryetar

Mimoza SADUHAJ

